

VENDIM
Nr. 501, datë 17.7.2019

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL DHE TË DISA OBJEKTEVE BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 13, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 1045”, ME VENDNDODHJE NË LAPRAKË, TIRANË, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 5 590 (pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 13, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 1045”, me vendndodhje në Laprakë, Tiranë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për realizimin e programeve arsimore dhe ndërtimin e një shkolle të re publike.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, hiqet sipërfaqja prej 5 590 (pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë) m², nga trualli funksional i pronës nr. 13, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 1045”, me vendndodhje në Laprakë, Tiranë, sipas planvendosjes, dhe shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Tiranë.

3. Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANVENDOSJE
e pronës nr.13 (Sipërfaqja dhe objektet) për kalim në pronësi të Bashkisë Tiranë

SISTEMI SHITETOROR I KOORDINATAVE

MIRATOHET
KOMANDANTI I REP. USHT. NR. 6630
Kolonel Arben **KINGJI**




579
350

579
250

579
150

4
579
050
4



Hartoi
Topograf Nikoll TUSHI

Shkalla 1:1000

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. Enea **SINOIMERI**



HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fragment)

**ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUJASHME**

TIRANA

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE
 ZONA KADASTRALE 8310 NR. I PASURISE 1216 V. 1216 242
 INDEKSI I HARTES 74 - 5.6 SHKALLA 1:1000
 ADRESA E PASURISE: Rr. VERDIT Q. PRANÇ
 Rr/L VERDIT NDIJE PG Sh K Ap

B. KUFIZIMET
 V. 12137 11/226
 L. 12127
 J. 1218 1216 1214
 P. 12137

C. PRONARIET
 R. P. U. SH. T. 6618
 S. T. 13970M2
 S. N. 3814.79M2

D. Data: 1/1, Ora:

M. KALLA 42494

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Vol. 12 , Fq. 242

Adresa e Pasurisë (Mëthi) PEQIN Q/F PEQIN PËRFUNDIMTARE (data): 28/10/2012

Rr/L _____ P/G _____ SH _____ K 0 Ap _____

Përshkrim i veçantë:

Lloji i Pasurisë: **TRUALL** Brenda V.K.N. : **PO** , Ref: **PL. RREG**

Sip. Totale e Pasurisë:		Nga Sip. Totale: sa Truall		Nga Sip. Truall: sa Ndërtësë		Për pjesën e përbashkët: PALLAT Kuota e pjesëmarrjes: _____% Nr i Pasurisë (pallat): _____ Vol _____ Faqe _____
1. <u>13970</u> m2	1. <u>13970</u> m2	1. <u>3814.79</u> m2				
Ref. <u>00003881</u>	Ref. _____	Ref. _____				
2. <u>14066</u> m2	2. <u>14066</u> m2	2. <u>3691</u> m2				
Ref. <u>I.N.2012</u>	Ref. _____	Ref. _____				
3. _____ m2	3. _____ m2	3. _____ m2				
Ref. _____	Ref. _____	Ref. _____				
4. _____ m2	4. _____ m2	4. _____ m2				
Ref. _____	Ref. _____	Ref. _____				

C - SEKSIONI I PRONËSISË

[illegible]